



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3540 prot.

Qafë-Mali, më 10.11.2025

PROCESVERBAL

**TEMA: KONSULTIM PUBLIK PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028,
BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026, PAKETA FISKALE 2026. .
NJËSIA ADMINISTRATIVE QAFË-MALI**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, **u mbajt sot, më 12.11.2025, në ambientet e Njesisë Administrative Qafë-Mali, Ora 11:00, dëgjesa publike mbi "Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, buxheti i bashkisë për vitin 2026, paketa fiskale 2026"**.

Në takim morën pjesë nga NjVQV:

1. Kryetar i Bashkisë, **Z. Hil Curri**
2. Zëvendëskryetar i Bashkisë, **Z. Mikel Qafa**
3. Sekretar për Këshillin Bashkiak, **Znj. Naze Selimaj**
4. Përgjegjës c Zyrës së Auditit, **Entela Pepa**
5. Përgjegjës për Zyrën e Emergjencave Civile, **Z Dod Pepa**
6. Përgjegjës për Policinë Bashkiake, **Z. Nikolin Qafa**
7. Specialiste IT në Bashki, **Albina Prenga**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjese publike janë banorët e Njesisë Administrative Qafë-Mali si dhe të fshatrave Kryezi, Qafë-Mali, Orosh, Lumbardh, Lajthizë, Tuç si dhe kryetarë të fshatrave.





Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në veçanti Kryetarin e Bashkisë Fushë-Arrëz, z. Hil Curri për dëgjuesën publike të organizuar me banorët e Njesisë Administrative Qafë-Mali. Jemi sot këtu në këtë konsultë të hapur mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin e bashkisë për vitin 2026, për të shpalosur prioritetet e bashkisë për vitin 2026, buxhet që i përket edhe Njesisë tonë. Gjithashtu jemi në këtë konsultë të hapur për të dhënë rekomandimet dhe sugjerimet tona lidhur me shqetësimet e përditshme që kemi në të gjithë sektorët e jetës, për rrugët, për

ujin, kanalizimet, ujësjellësat e me radhë, për buxhetin e vitit 2026. Administratori i Njesisë Administrative **Z. Mirash Mardodaj** e konsideron dëgjuesën shumë të rëndësishme në mbështetje të nevojave që kanë banorët e Njesisë Administrative Qafë-Mali.

Në vijim fjalën e merr **Kryetari i Bashkisë, Z. Hil Curri:**

Ju falënderoj për praninë tuaj në këtë dëgjuesë publike, e cila ka një rëndësi të veçantë për bashkinë tonë.

Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë çdo kërkesë dhe nevojë tuajën për shërbime publike në mënyrë që të ndërtojmë një buxhet sa më afër realitetit.



Gjatë kësaj kohe kemi arritur të krijojmë një numër të konsiderueshëm vendesh pune, duke kontribuar në rritjen e mirëqenies së komunitetit. Dua të theksoj se marrëdhëniet e mia me pushtetin qendror kanë qenë dhe mbeten jopartiake, duke u fokusuar vetëm në interesin e banorëve dhe zhvillimin e zonës.

Falë përpjekjeve tona dhe bashkëpunimit të ngushtë me institucionet, kemi arritur të pajisim bashkinë me një fadromë për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve të domosdoshme për përmirësimin e infrastrukturës. Së shpejti, pritjet të shtohen edhe një bumkat dhe një kamionçinë të cilat do të rrisin ndjeshëm kapacitetet tona të punës në terren.

Gjithashtu ne si bashki këtë vit kemi pasë një rritje të buxhetit si pasojë e mbledhjes së detyrimeve tatimore, më e larta në këto vite. Nga ana tjetër jemi edhe përballë faturave që i kanë ardhë bashkisë nga problematikat e lëna nga pararendësit, por pavarësisht kësaj, kemi arritur të realizojmë një sërë shërbimesh falë bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm

Me fondet që kemi pasur në dispozicion, kemi bërë të mundur mirëmbajtjen e rrugëve, hapjen e vijave vaditëse të tokave bujqësore dhe kryerjen e punimeve të tjera të rëndësishme për komunitetin. Po llojmë çdo ditë e më shumë për të sjellë fonde dhe investime të reja në zonë. Fondi i Zhvillimit Shqiptar ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve përmes projekteve dhe shërbimeve të ndryshme.

Fshati juaj është i shpallur zyrtarisht fshat turistik, dhe ne po përpiqemi të qëndrojmë sa më pranë prioritetëve dhe standardeve të Bashkimit Europian për zhvillimin rural dhe turizmin. Me ardhjen e mjeteve dhe pajisjeve të reja, do të jemi në gjendje të ofrojmë edhe shërbime të tjera që i shërbejnë drejtpërdrejt komunitetit.

Duhet të them se kemi gjetur shumë punë të pambyllura nga paraardhësit, por pavarësisht kësaj, kemi arritur të realizojmë një sërë shërbimesh falë bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm dhe angazhimit të stafit të bashkisë.

Jam plotësisht i gatshëm t'ju dëgjoj me kujdes sot, kërkesat dhe rekomandimet tuaja, në mënyrë që buxheti i vitit 2026 të jetë sa më i prekshëm, realist dhe i dobishëm për zonën tuaj. Faleminderit edhe një herë për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin tuaj të çmuar.

Përveç kësaj dëgjese, mund të na shkruani edhe në faqen tonë zyrtare, në faqen zyrtare të bashkisë: <https://bashkiafushearrez.gov.al/>, email info@bashkiafushearrez.gov.al e cila është e aksesueshme dhe e hapur për të gjithë qytetarët që kanë pyetje, mendime apo propozime.

Agim Pashkaj, Kryetar i fshatit Lajthizë:

Përshëndetje të gjithëve! Faleminderit që na keni mbledhur!

Unë vetë me pronarin e fabrikës së Lajthizës kemi vendosë themelet e asaj fabrike të ujit që gjendet tashmë në fshatin tonë duke rënë dakord menjëherë sepse ishte një mirësi për zhvillimin e zonës.

Falenderoj Administratorin e Njesisë Administrative për punën që bën. E kam gjetë duke punuar vetë për pastrimin e varrezave, bravo!



- ✚ Ne si banorë të fshatit Lajthizë kemi nevojë për fadromën në mënyrë që të pastrojmë rrugët kur ka reshje shiu.

Gjovalin Bardhoku, Kryetar i fshatit Qafë-Mali:

Punësimi është në nivelin më të lartë sepse kemi gjithë këto fabrika në zonën tonë por kemi disa kërkesa të tjera:

- ✚ Kemi nevojë për fadromën në mënyrë që të pastrojmë rrugët kur ka reshje shiu.
- ✚ Kemi nevojë për tuba te vijave.
- ✚ Kërkojmë pastrimin e rrugës për të dalë te lagja Palucaj.
- ✚ Kërkojmë pastrimin e rrugës për të dalë te varrezat.
- ✚ Problem kalimi te ura e Tuçit, Kërkohet pastrimi me mjete.
- ✚ Kërkojmë të bëhen kanalizime, pastrim turbine te ura e Tuçit dhe asfaltim të rrugës.



Mikel Qafa, Zëvendëskryetar i bashkisë:

Përshëndetje të gjithëve! Faleminderit që jeni sot këtu në këtë bashkëbisedim lidhur me prioritetet tuaja. Sa më sipër e kemi biseduar me Kryetarin, kemi marrë mesazhin për këtë problematikë, për një periudhë deri verën që vjen do kemi asfaltimin e rrugës në fjalë.

Pal Mardodaj, banor i Njësisë:

Ne ju jemi mirënjohës për çdo punë dhe përpjekje që bëni në shërbim të komunitetit tonë.

Ne si lagje kemi disa kërkesa:

- ✚ Të mbrohen pyjet nga zjarri.
- ✚ Të mbulohen tubat e ujësllësit.
- ✚ Të bëhet një rrugë alternative për te ujëvara e Kryeziut, është e rëndë për mua si familjar të kalojnë gjithë njerëzit nëpër oborrin e shtëpisë për te ujëvara, është e papranueshme.
- ✚ Rruga që kemi është e pamjaftueshme në parametrat e gjerësisë për tu kthyer zjarrfikësja apo ambulanca.



Mirash Mardodaj, Administrator i Njësisë Administrative Qafë-Mali:

Unë i kam përcjell dhe vazhdoj t'i përcjell problematikat tuaja dhe jam përpjek edhe me punu vetë se njerëzit janë larguar dhe s'ka fuqi punëtore. Disa kërkesa janë:

- ✚ Pastrimi i rrugëve mbas shiut.
- ✚ Të ndërhyhet në kohë për bërjen e vijave vaditëse dhe ndërtimin e jazeve, duhen mure mbajtëse.
- ✚ Të rregullohet Rezevuari i ujit të pijshëm.



Ndrek Çukaj, Kryetar i fshatit Kryezi:

Kemi problematika në fshatin Kryezi lidhur me ujin e pijshëm dhe atë vaditës.

Në lagjen time, në lagjen Mejdan nuk shkon uji sikurse edhe te Marash Koliçi.

- ✚ Kërkojmë të bëhet e mundur të kemi ujë të pijshëm në shtëpitë e fshatit.
- ✚ Të pastrohet dhe mirëmbahet rruga e Aliajve, Oroshit, rruga që bie te shkolla dhe te shtëpia e Kol Kolicës



Hil Curri, Kryetar i bashkisë:

Ujësjiellësi menaxhohet nga SIHA Shkodër, mendoj të vendosen matësit e ujit në mënyrë që të zgjidhet kjo situatë. Ne do të sjellim materiale ndërtimi, çementë, tuba, rregullojmë pusëtën dhe shërbime të domosdoshme



Lek Palushi, banor i fshatit Kryezi:

- 🚦 **Kërkojmë ujë të pijshëm, lagje pa ujë.**
- 🚦 **Të pastrohet rruga e Kishës.**
- 🚦 **Të pastrohet turbina nga firma që po bën punimet e hidrocentralit.**



Hil Curri, Kryetar i bashkisë:

Të gjitha dëmet që shkakton firma është e detyruar t'i riparojë.

Ju faleminderit që ishit sot këtu dhe na ndihmuat në plotësimin e programit për buxhetin përmes kërkesave, rekomandimeve dhe sugjerimeve tuaja.



Bashkëlidhur këtij procesverballi, gjendet lista e pjesëmarrësve në këtë dëgjese publike dhe Rekomandimet nga dëgjesa.

SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Naze SELIMATI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

PËR:

- **Z. HIL CURRI, KRYETAR I BASHKISË**
- **KOMISIONIN E EKONOMISË FINANCË-BUXHETIT**
- **KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ**

**PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE NGA DËGJESA PUBLIKE
NJËSIA ADMINISTRATIVE QAFË-MALI**

Lënda: Përmbledhje e rekomandimeve me prioritetet e komunitetit dalë nga konsultimi publik mbi programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin e Vitit 2026 si dhe Paketën Fiskale 2026, Njësia Administrative **Qafë-Mali**, më 10.11.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kalendarit të konsultimit publik, Rregullores për funksionimin e Këshillit Bashkiak, u zhvillua konsultimi publik për programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin e Vitit 2026 si dhe paketën fiskale 2026, në ambjentet e Njesisë Administrative **Qafë-Mali**.

Qëllimi i dëgjës: Tërheqja e mendimeve, propozimeve dhe kërkesave për Buxhetin e Vitit 2026, kryesisht për Programin Buxhetor 2026-2028.

Grupet që u konsultuan: Banorët e Njesisë Administrative Qafë-Mali, Kryetarët e fshatrave, punonjës të administratës, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim: 23 (5 Femra)

Mbështetur në Procesverbalin e dëgjësës publike, mbajtur me datë 10.11.2025

Rekomandimet e dhëna nga banorët e Njesisë Administrative Qafë-Mali janë:

- Të pastrohen rrugët kur ka reshje shiu.
- Kërkohen tuba për vijat vaditëse.
- Të pastrohet rruga për të dalë te lagja Palucaj.
- Të pastrohet rruga për të dalë te varrezat.
- Problem kalimi te Ura e Tuçit, kërkohet pastrimi me mjete.

- Të bëhen kanalizime, pastrim turbine te Ura e Tuçit dhe asfaltim të rrugës.
- Të mbrohen pyjet nga zjarri.
- Të mbulohen tubat e ujësjellësit.
- Të bëhet një rrugë alternative për te Ujëvara e Kryeziut.
- Rruga që të nxjerr te shtëpia e Pal Mardoda është e pamjaftueshme në parametrat e gjerësisë për tu kthyer zjarrfikësja apo ambulanca.
- Të ndërhyhet në kohë për bërjen e vijave vaditëse dhe ndërtimin e jazeve, duhen mure mbajtëse.
- Të rregullohet Rezevuari i ujit të pijshëm.
- Të mundësohet ujë i pijshëm në shtëpitë e fshatit.
- Të pastrohet dhe mirëmbahet rruga e Aliajve, Oroshit, rruga që bie te shkolla dhe te shtëpia e Kol Kolicës
- Të pastrohet rruga e Kishës.
- Të pastrohet turbina nga firma që po bën punimet e hidrocentralit.
- Të ndërhyhet për riparim në rrugën që lidh Bardhetin me Qafën e Barit, Lakun e Roshit dhe Lumbardhin, kjo rrugë është dëmtuar si pasojë e kalimit të mjeteve me tonazh të lartë.

Nga ana e pjesëmarrësve u kërkua që brenda mundësive të buxhetit, zgjidhja e rekomandimeve të mësipërme të pasqyrohet në buxhetin e vitit 2026 dhe në vazhdim.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

Sekretar për Këshillin Bashkiak

Naze SELIMAJ



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË: PROGRAMI
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETA FISKALE 2026.

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Dod Pega		Dod-Mali	Trp. Pyjesh	
2.	Entela Pepa		Qafë-Mali	Juriste	
3.	DORONTI		VASAHEGË		
4.	Gjergj Dedaj		Bardhet		
5.	Anton Pjetri		Bardhet		
6.	Shqipe Arifaj		Bardhet	Arkive - Prot	
7.	Xhuana Gjergj		Bardhet		
8.	Emanuel Mardodaj		Bardhet		
9.	WILY RERI				
10.	Morok Sulaaj		Qafë-Mali	Trupetar fshat	
11.	Zef Holoci				
12.	Sokol Alice				
13.	Arrok Mardodaj				
14.	Doke Sulaaj				



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË: PROGRAMI
BUXHIETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETA FISKALE 2026.

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Dal	Mardodaj			
2.	Azrim	Podgaj			
3.	Pashtek	Bilbasj			
4.	Qervolin	Borollidze	Çob-Mali	Shofer	
5.	Mikel	Qafa		Zv. kryetar	
6.	MIRASH	MARDODAJ			
7.	Naze	Selimonaj	Fushë-Arrëz	Shërbetore e KB	
8.	Albina	Trenga	Fushë-Arrëz	Specialiste IT	
9.	Hil	Curri	Bashkia	Kryetare Bashkie	
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3630 prot.

Fushë-Arrëz, më 14.11.2025

PROCESVERBAL

**TEMA: KONSULTIM PUBLIK PËR PROGRAMIN BUXHIETOR AFATMESËM 2026-2028,
BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026, PAKETA FISKALE 2026.
NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË-ARRËZ, QENDËR & BIZNESI**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, u mbajt sot, më 14.11.2025, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, ora 10:00, dëgjesa publike mbi "Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, buxheti i bashkisë për vitin 2026, paketa fiskale 2026".

Në takim morën pjesë nga NJVQV:

1. Kryetar i Bashkisë, **Z. Ilir Curri**
2. Drejtor i Zyrës së Financës, **Z. Dritan Lika**
3. Përgjegjës i Sektorit Tatim-Taksave, **Vilson Prenga**
4. Sekretar për Këshillin Bashkiak, **Znj. Naze Selimaj**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjese publike janë banorët e qytetit Fushë-Arrëz si dhe të fshatrave Fushë-Arrëz, Lumardh dhe Micoj të kryesuar nga kryetarët respektivë të fshatrave Fushë-Arrëz dhe Lumardh, Lekë Curri, dhe Mark Gega. Në takim janë të pranishëm drejtues të institucioneve, përfaqësues nga shoqëria civile, biznesi, punonjës të administratës etj.





Fjalën hapëse e mbajti Kryetari i Bashkisë,

Z. Hil Curri:

Përsëritje, mirë se erdhët!

Sot jemi mbledhur për të zhvilluar dëgjuesën publike për Buxhetin 2026, një proces që nuk është thjesht formalitet ligjor, por një detyrim moral, institucional dhe qytetar. Këto dëgjesa

janë thelbi i transparencës dhe i bashkëqeverisjes, sepse vetëm përmes komunikimit të hapur dhe pjesëmarrjes suaj të drejtëpërdrejtë mund të ndërtojmë një buxhet që i përgjigjet vërtet nevojave të komunitetit dhe vizionit të përbashkët për zhvillimin e bashkisë.

Dëgjuesat publike janë një mundësi që të dëgjojmë të gjithë, që nga qytetari i thjeshtë, tek fermerët, bizneset, të rinjtë, përfaqësuesit e institucioneve dhe çdo grup interesi. Nëpërmjet këtij procesi ne mbledhim problematikat, shqetësimet, propozimet dhe idetë tuaja, të cilat pasqyrohen në dokumentin më të rëndësishëm financiar të një Njësie Vendore: Buxhetin Vjetor dhe Planin e Buxhetit Afatmesëm 2026-2028.

Sot janë me ne Drejtori i Financës dhe Përgjegjësi i Sektorit të Tatim-Taksave.

Dua t'ju informoj se Bashkia jonë këtë vit është përballur me vështirësi financiare për shkak të faturave të prapambetura që kanë ardhur nga përmbarimi. Ndërkohë që të ardhurat tona vjetore janë rreth 30 milion lekë, na ana tjetër, 30 milion lekë janë sekuestruar në muajin tetor nga gjyqet e fituara ndaj bashkisë. Kjo situatë na ka vendosur përballë detyrimit për të analizuar thellësisht mënyrën se si krijohen dhe si shpenzohen të ardhurat.

Falenderoj të gjithë punonjësit e institucionit që kanë likuiduar taksat e tyre. Kjo praktikë nuk ekzistonte më parë, por duhet shtrirë në çdo hallkë, çdo qytetar duhet të paguajë taksat për të marrë shërbime cilësore. Vetëm kështu garantojmë funksionim të qëndrueshëm të shërbimeve bazë.

Në bashkinë tonë nuk kemi sot të varfër. Shumica e banorëve janë të punësuar falë industrisë që është zhvilluar ndër vite, fabrika, miniera, fabrika uji, hidrocentrale e biznese të tjera. Madje, me hapjen e minierës së re mbi qytet, jemi në situatën ku ka vende punë, por mungojnë punëtorët. Kjo tregon se zona ka potencial dhe kërkon zhvillim të mëtejshëm.

Detyra jonë është të rrisim të ardhurat vendore, por të ardhurat nuk vijnë vetë, ato duhen krijuar përmes vizionit të përbashkët. Një mundësi shumë e rëndësishme është investimi në parqe fotovoltaike dhe energji të rinovueshme. Çdo fond pyjor i dhënë me qira për projekte të tilla gjeneron të ardhura për bashkinë, rrit punësimin dhe krijon më shumë shërbime për qytetarët.

Kjo përbën një sfidë të madhe për zhvillimin e territorit dhe për realizimin e projekteve strategjike. Prandaj rritja e të ardhurave vendore është e domosdoshme.

Dua të falenderoj Këshillin Bashkiak i cili ka qenë bashkëpunues dhe mbështetës në çdo vendimarrje që ka synuar rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e performancës financiare.

Aktualisht, 90% e buxhetit të bashkisë shkon për paga dhe sigurime, ndërsa vetëm 10% për shërbime si mirëmbajtje, ndriçim publik dhe operacione të përditshme. Për këtë arsye, mendimet tuaja janë të domosdoshme për të ndërtuar jo vetëm buxhetin e vitit të ardhshëm, por edhe Planin e Buxhetit Afatmësëm (PBA) 2026–2028.

Shtoj këtu se kemi një interes shumë të madh nga kompani të ndryshme që kërkojnë të investojnë në bashkinë tonë. Kjo tregon se zona jonë është atraktive dhe ka potencial zhvillimi. Detyra jonë është ta shfrytëzojmë këtë potencial me përgjegjësi dhe transparencë.

Një çështje tjetër strategjike për të ardhmen e bashkisë është Paketa e Maleve. Kjo hap mundësi për investime në agroturizëm, energji të gjelbër, energji ujore, komplekse turistike dhe shumë fusha të tjera. Deri tani kemi rreth 56 kërkesa për projekte, veçanërisht nga zona e liqenit për shfrytëzimin e ujit. Dua të theksoj qartë se asnjë investim nuk është i gabuar, për sa kohë respekton ligjin dhe zhvillohet në mënyrë transparente. Nuk flitet për zënie të tokave, për çdo projekt do të zhvillohen dëgjesa publike, siç e kërkon ligji.

Kemi projekte infrastrukturore të trashëguara që po përpiqemi t'i çojmë përpara. Vijat vaditëse janë prioritet, por është e rëndësishme të kuptohet se shërbimet funksionojnë vetëm kur ato paguhen dhe kur ka ndërgjegjësim qytetar për përgjegjësitë financiare.

Kemi ftuar edhe bizneset, pasi rritja e referencës tatimore sjell rritje të lehtë të tatimit për to, dhe duam sa më shumë transparencë dhe dialog.

Një problem i vazhdueshëm mbetet ai i furnizimit me ujë, si në aspektin e të ardhurave të ulëta të ndërmarrjes, ashtu edhe të cilësisë së shërbimit. Kemi situata ku shërbimi është ulur, ndërsa tarifa është rritur. Kjo është e papranueshme.



Dritan Lika, Drejtor i Zyrës së Financës:

Gjatë procesit të analizimit dhe hartimit të buxhetit për vitin 2026, janë trajtuar të gjitha problematikat e identifikuara në nivel sektorial dhe institucional. Buxheti i vitit të ardhshëm paraqet një rritje të detyruar ligjore në raport me vitin aktual, në zbatim

të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili përcakton se çdo vit pasardhës duhet të ketë një nivel buxheti më të lartë se ai pararendës.

Megjithatë, dua të theksoj se kjo rritje është minimale dhe nuk reflekton plotësisht nevojat reale të territorit. Bashkia jonë, pavarësisht numrit të banorëve, ka një shtrirje të gjerë gjeografike dhe një sërë resurset natyrore, të cilat gjenerojnë të ardhura që kryesisht i shkojnë qeverisjes qendrore. Bashkia mbledh një sasi të kufizuar të ardhurash vendore, të përqendruara kryesisht në taksën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, të cilat janë të pamjaftueshme për mbulimin e nevojave të zhvillimit lokal.

Duke marrë në konsideratë strukturën organizative dhe ndërmarrjet e varësisë, një pjesë dominuese e buxhetit dedikohet për pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative. Megjithatë, dua të nënvizoj se Bashkia nuk ka planifikuar asnjëherë një buxhet pa investime, edhe këtë vit, pavarësisht kufizimeve financiare, do të realizohen disa investime në vlera modeste, duke u mbështetur në projektet ekzistuese të gatshme për financim.

Për të kompensuar mungesat e fondeve të brendshme, Bashkia ka aplikuar pranë ministrive të linjës me projekte konkrete, me synimin për të siguruar mbështetje financiare nga qeverisja qendrore. Viti 2026 parashikohet të jetë një vit sfidues në aspektin financiar, edhe për shkak të detyrimeve që burojnë nga disa vendime gjyqësore.

Megjithatë, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e qytetarëve, jemi të bindur se do të miratojmë një buxhet realist, objektiv dhe të zbatueshëm, në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit tonë. Ju falenderoj për vëmendjen!

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë:

Tani dua t'ju jap fjalën juve, sepse këtu fillon pjesa më e rëndësishme e këtij procesi. Tani është koha që të shprehni kërkesat, rekomandimet dhe sugjerimet tuaja për Buxhetin 2026. Mund të flisni për çdo çështje që lidhet me shpërndarjen e buxhetit, investimet në infrastrukturë, Paketën e Maleve, energjinë e rinovueshme, shërbimet publike, apo çdo ide tjetër që mendoni se ndihmon zhvillimin e bashkisë.

Përveç kësaj dëgjese, mund të na shkruani edhe në faqen tonë zyrtare, në faqen zyrtare të bashkisë: <https://bashkiafushearrez.gov.al/>, email info@bashkiafushearrez.gov.al e cila është e aksesueshme dhe e hapur për të gjithë qytetarët që kanë pyetje, mendime apo propozime.

Ju jeni të mirëpritur të diskutoni, të sugjeroni, dhe të propozoni ide të reja. Prandaj zëri juaj është i domosdoshëm.

Mark Gega, Kryetar i fshatit Lumardh:

Kërkesat tona si fshat janë:

- ✚ Mirëmbajtja dhe rregullimi i rrugëve për në fshatin Lumardh.
- ✚ Shërbime të ndryshme brenda mundësive.



Lek Curri, Kryetar i fshatit Fushë-Arrëz:

Në cilësinë e kryetarit të fshatit Fushë-Arrëz, ju falenderojmë për takimin e organizuar dhe për punët dhe shërbimet ndaj komunitetit.

- ✚ Fshati Fushë-Arrëz duhet të hyjë në sistemin e ujit të pijshëm të qytetit.
- ✚ Të ulet çmimi i ujit të pijshëm.
- ✚ Të mundësohet hapja e vijave vaditëse të tokave bujqësore në fshatin Fushë-Arrëz, të vendosen tuba.
- ✚ Të rrethohen dhe të zgjerohen varrezat e dy varianteve në fshatin Fushë-Arrëz.
- ✚ Të shtrohet me Asfalt rreth 50 metër rrugë që bashkon rrugën kryesore me Çerdhen e fëmijëve.
- ✚ Të mbulohen mbeturinat e hedhura në terren në fshatin Fushë-Arrëz.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë: Sa i përket biznesit, në varësi të çmimit të referencës është parashikuar një rritje e vogël e taksave të



bizneseve. Jam tejet i shqetësuar sa i përket çmimit të ujit të pijshëm i cili është kundërshtuar nga Këshilli Bashkiak dhe nga të gjithë banorët sepse nuk ka ndonjë shërbim ekstra, uji është me rrjedhje të lirë. E papranueshme rritja galopante e çmimit të ujit në Bashkinë tonë. ShA ka vepruar në kundërshtim me Këshillin Bashkiak dhe me gjithë banorët.



Është sistemuar luhatja e çmimeve. Unë besoj se nuk ka biznes që abuzon me nivelin e çmimeve. Ne si bashki jemi të destinuar t'ju krijojmë klimë të qetë në mënyrë që ju të vazhdoni në harmoni biznesin tuaj.

Nëse keni ndonjë shqetësim, kërkesë apo ankesë, është momenti juaj.

Vilson Luka, sipërmarrës i Market Luka:

- Të ndalohen konkurentët që vijnë me makina e shesin mandarina dhe artikuj të tjerë nga Laçi i Vaut të Dejës apo nga rrethet e tjera me çmime konkurruese.



Albert Pepa, sipërmarrës:

- Të ndalohen personat që vijnë me furgona dhe makina duke shitur në rrugët e qytetit mallrat e njëjtë me ato të dyqaneve tona

Qamil Syla, sipërmarrës:

- Ka rënë shumë numri i blerësve të materialeve bujqësore.
- Shqetësim për ne mbetet çmimi i ujit.
- Të ndalohen konkurentët që vijnë me makina e shesin me çmime konkurruese të njëjtin mall që kanë dyqanet tona.



Ilir Curri, Kryetar i Bashkisë:

Faleminderit për pjesëmarrjen, për angazhimin dhe për dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e bashkisë sonë.



Bashkëlidhur këtij procesverbali, gjendet lista e pjesëmarrësve në këtë dëgjese publike dhe Rekomandimet nga dëgjesa.

SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Naze SELIMAJ



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

PËR:

- **Z. HIL CURRI, KRYETAR I BASHKISË**
- **KOMISIONIN E EKONOMISË FINANCË-BUXHETIT**
- **KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ**

**PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE NGA DËGJESA PUBLIKE
NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË-ARRËZ, QENDËR & BIZNESI**

Lënda: Përmbledhje e rekomandimeve me prioritetet e komunitetit dalë nga konsultimi publik mbi programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin e Vitit 2026 si dhe Paketën Fiskale 2026, Njësia Administrative **Qendër, Fushë-Arrëz** më 14.11.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kalendarit të konsultimit publik, Rregullores për funksionimin e Këshillit Bashkiak, u zhvillua konsultimi publik për programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin e Vitit 2026 si dhe paketën fiskale 2026, në në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak **Fushë-Arrëz**.

Qëllimi i dëgjësës: Tërheqja e mendimeve, propozimeve dhe kërkesave për Buxhetin e Vitit 2026, kryesisht për Programin Buxhetor 2026-2028.

Grupet që u konsultuan: Banorët e Njesisë Qendër, Fushë-Arrëz, të fshatrave Fushë-Arrëz, Lumardh, Micoj, Kryetarët e fshatrave, Shoqëria civile, Sipërmarrës të biznesit, punonjës të administrates, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim: 42 (20 Femra)

Mbështetur në Procesverbalin e dëgjësës publike, mbajtur me datë 14.11.2025

Rekomandimet e dhëna nga banorët e Njesisë Administrative Qendër, Fushë-Arrëz janë:

- **Mirëmbajtja dhe rregullimi i rrugëve për në fshatin Lumardh.**
- **Fshati Fushë-Arrëz duhet të hyjë në sistemin e ujit të pijshëm të qytetit.**
- **Të ulët çmimi i ujit të pijshëm.**
- **Të mundësohet hapja e vijave vaditëse të tokave bujqësore në fshatin Fushë-Arrëz (të vendosen tuba).**
- **Të rrethohen dhe të zgjerohen varrezat e dy varianteve në Fshat të Fushë-Arrëzit.**

- Të shtrohet me Asfalt rreth 50 metër rrugë që bashkon rrugën kryesore me Çerdhen e fëmijëve në qytet
- Të mbulohen mbeturinat e hedhura në terren në fshatin Fushë-Arrëz, rrezikojnë përhapje të sëmundjeve.
- Të ndalohen konkurentët që vijnë me makina e shesin mandarina dhe artikuj të tjerë nga Laçi i Vaut të Dejës apo nga rrethe të tjera me çmime konkurruese.
- Të ndalohen personat që vijnë me furgona dhe makina duke shitur në rrugët e qytetit mallrat e njëjtë me ato të dyqaneve në Fushë-Arrëz.
- Ka rënë shumë numri i blerësve të plehrave kimikë dhe produkteve të ngjashme.
- Shqetësim mbetet çmimi i ujit.
- Të ndalohen konkurentët që vijnë me makina e shesin me çmime konkurruese të njëjtin mall që kanë dyqanet tona.

Nga ana e pjesëmarrësve u kërkua që brenda mundësive të buxhetit, zgjidhja e rekomandimeve të mësipërme të pasqyrohet në buxhetin e vitit 2026 dhe në vazhdim.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

Sekretar për Këshillin Bashkiak

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË: PROGRAMI
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETA FISKALE 2026. (NJËSIA QENDËR, BASHKIA FUSHË-ARRËZ)

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Klotilda	Curri	Fushë - Arrëz	Përgjegjëse e Sëhtjeve Sociale	
2.	Vitore	Cora	Fushë - Arrëz	Specialiste Arkive	
3.	Mark	Gega	Lumardh	Kryeplak. i Fshatit	
4.	Rehana	Hasani	Fushë - Arrëz	Përgjegjëse Juriste	
5.	Desara	Iloca	Fushë - Arrëz Sp. Bujqësori dhe Bujqësi	Sp. Bujqësori dhe Bujqësi	
6.	Jehë	Curri	Fishotë - Fsh. Arrëz	k/fishotë	
7.	Artant	Lupaj	fushë arrëz		
8.	Fationa	Selima	Fushë - Arrëz	Drejtoresh e Bujqësisë dhe Bujqësi	
9.	Zonida	Prela	Fushë - Arrëz	Specialiste e Prokurimeve Publike	
10.	Flodiana	Pjetra	Fushë - Arrëz	Përgjegjëse Gj. Civile	
11.	Silvana	Gjergji	Fushë - Arrëz	Edukatore	
12.	Lindita	Dleshi	Fushë - Arrëz	Sp. ndihmë ekonomike	
13.	Dukate	Pukaj	- " -	Kordinatore Dhune	
14.	Mirela	Mimo	Fushë - Arrëz	Përgjegjëse Serdhe	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË: PROGRAMI
BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETA FISKALE 2026. (NJËSIA QENDËR, BASHKIA FUSHË-ARRËZ)

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Aje Oofa		Fushë-Arrëz	Drejtoreshë	
2.	Edmonde Delia		Fushë-Arrëz	Edukatore	
3.	Merite Alije		Fushë-Arrëz	Edukatore	
4.	Jetmina Murataj		Fushë-Arrëz	Specialiste	
5.	ELVIN HAXHA		SHKODER	Jurist	
6.	Albino Prenga		Fushë-Arrëz	Specialist IT	
7.	Violeta Vukaj		Fushë-Arrëz	INSP PB	
8.	Valbona Milla		Sp.k. Bashkia	F.A.	
9.	Arina Simoni		Fushë-Arrëz	Drejtoreshë	
10.	Moh Lepura		Fushë-Arrëz	Sp.C. Juridike	
11.	Vilson Prenga		Fushë-Arrëz	Peigj. Tatim-Taksa	
12.	Nezir Ahmeti		Fushë-Arrëz	Sp. Em. Civile	
13.	Altin Enxhelli		Fushë-Arrëz	Sp. Arsime, Kultur	
14.	Parthë Prendh		Drejt. N.B. FA	B.F.A	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË: PROGRAMI
BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE
PAKETA FISKALE 2026. (Me përfaqësues të biznesit)

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Valbona	Doda	F. Arrëz	Estetiste	[Signature]
2.	Mark	Tofaj	F. Arrëz	SERVIS	[Signature]
3.	Vilson	Gjuka	Fushë - Arrës	Market	[Signature]
4.	Bert	Pepa	Fushë - Arrës	Market	[Signature]
5.	Buyan	Sochipe	Fushë - Arrës	Antikaj Mbyllur	B. Sochipe
6.	Driton	Frrokaj	Fushë - Arrës	Furr Bulce	[Signature]
7.	Parviz	Reza	Fushë - Arrës	Bar Barf.	[Signature]
8.	Age	Oqfu	Fushë - Arrës	Lokal	[Signature]
9.	Mirela	Memoj	Fushë - Arrës	Lokal	[Signature]
10.	Nexhmije	Katroshi	Fushë - Arrës	Dyqan. veshje rraban	[Signature]
11.	Dukate	Milla	Fushë - Arrës	Mini-Market	[Signature]
12.	Driton	Lika	Bashkia F-Arrës	Drejtor i Zyrës së Financës	[Signature]
13.	Vilson	Gjergj	Gjegjësi i Zyrës së Tërit-Taksave	Bashkia Fushë - Arrës	[Signature]
14.	Naze	Selimoj	Bashkia F-Arrës	Shkretare e KB	[Signature]